



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipal Kačanik

01Nr.400/01-6386/26  
Kaçanik, 30.03.2026

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 30 mars 2026, pos tjerash;

### NJOFTOHET

1. Me Raportin e Periodik për Zbatimin e Rekomandimeve për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2024.
2. Në Raportin si në pikën 1 të kësaj shkrese, është paraqitur progresi i zbatimit të rekomandimeve që dalin nga Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit, për të gjeturat në Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin 2024.
3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese është: Raporti periodik për Zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit/ Lënda: 01Nr.400/01-6386/26.

Më këtë shkresë njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
Selajdin Troni



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik/ Municipality of Kaçanik

Zyra e Kryetarit



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



Data	17.03.26	Vendi	KAÇANIK
Proj. org.	Numri	Shtojcë	
01	400/01-6386	/	

DATE	15 mars 2026
REFERENCË	
PËR/ZA/TO:	Vlora Spanca- Auditore e Përgjithshme Zyra Kombëtare e Auditimit
CC:	Selajdin Troni- Kryesues Kuvendi Komunal Kaçanik
PËRMES/PREKO/THROUGH NGA/OD/FROM:	Sabedin Vishi- Zyrtar Kryesor Administrativ Kryetar i Komunës së Kaçanikut
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport Periodik për zbatimin e rekomandimeve për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut për vitin 2024



*Të nderuar,*

Në bazë të nenit 14, pika 5 të Rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit (Rreg. Nr. 1/63, datë: 21.06.2019), në fuqi nga qershori 2019, ku përcaktohet se pas hartimit të planit të veprimit, entiteti i audituar i dorëzon Auditorit të Përgjithshëm dhe Kuvendit/aksionarit raporte lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve, të cilat dorëzohen dy herë në vit, respektivisht deri më 30 shtator dhe 15 mars.

Prandaj, në përgjigje të kësaj kërkesë, Komuna e Kaçanikut ka përgatitur këtë raport lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve që dalin nga Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2024.

*Me respekt!*

Nr.	Komponenta e Auditimit (Kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmara dhe rezultate konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimit	Statusi i rekomandimit	Sfidat e hasura në zbatimin e rekomandimit
1	Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	Sipas gjetjeve të auditimit kemi vërejtur se janë bërë pagesa nga kodet joadekuate, në vlerë prej 458,448€. Nga kjo vlerë thesari kishte paguar sipas vendimit përbarimor/të gjykatës për paga jubilarë, shujta dhe kualifikim për arsimtar nga kategoria investimet kapitale pagesa në vlerë 410,561€, mallra dhe shërbime në vlerë 22,122€, nga komunalit në vlerë 15,499€ dhe nga subvencionet dhe transfertet pagesa në vlerë 10,266€. Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet.	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV.	Këto pagesa janë ekzekutuar nga Departamenti i Thesarit (MFPT), pa propozim nga Komuna lidhur me kategorinë ekonomike nga e cila duhet të tërhiqen mjetet. Shumica e këtyre shpenzimeve i përkasin natyrës së kategorisë paga dhe shtesa, mirëpo komuna nuk e ka mundësinë e zotimit nga kjo kategori për raste të tilla, andaj shpenzimet që burojnë nga vendimet gjyqësore/përbarimore ekzekutohen nga kategori të tjera ekonomike. Pjesa më e madhe e kësaj vlere ka ardhur si pasojë e obligimeve nga Kontrata Kolektive në arsim, e nënshkruar nga Qeveria, ndërsa barra financiare ka mbetur te komuna. Komuna vazhdimisht ka kërkuar nga Thesari (MFPT) që në raste të tilla të ketë konsultim paraprak me komunën për kategorizimin e saktë ekonomik të pagesave.	Pjesërisht i zbatuar	Sfida kryesore ka qenë mungesa e konsultimit paraprak me komunën nga ana e Thesarit, si dhe obligimet e paplanifikuara që burojnë nga Kontrata Kolektive në arsim.

2	<p>Çështja A1 - Mos regjistrimi i pasurive në regjistra kontabël</p>	<p>Sipas Rregullores Nr. 02/2013 "Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore", neni 6 përcakton se: pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria".</p> <p>Në bazë të mostrave të testuar, në dy (2) raste në vlerë 14,894€ pasurit jo kapitale nuk ishtë regjistruar në sistemin e-pasurisë, si pajisje të teknologjisë informative në vlerë 5,150€ dhe kompresor me pajisje tjera në vlerë 9,744€. Pasuri nën 1,000€ nuk janë regjistruar në e-pasuri nga mungesa e komunikimit të ndërsjellët i zyrtarëve përgjegjës.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar saktë në regjistrat kontabël sipas kërkesave ligjore.</p>	<p>Pas pranimit të gjetjes, janë ndërmarrë veprime për përmirësimin e komunikimit dhe koordinimit ndërmjet zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin e pasurisë, me qëllim që pasuritë jo kapitale dhe stoqet të regjistrohen me kohë në sistemin e-pasuria. Gjithashtu, është rritur kujdesi nga zyrtarët përgjegjës që pasuritë e pranuar të evidentohen në regjistrat përkatës kontabël.</p>	<p>Pjesërisht i zbatuar</p>	<p>Sfida kryesore ka qenë mosregjistrimi me kohë i pasurive nën 1,000€ ka ndikuar që jo të gjitha pasuritë të pasqyrohen menjëherë në sistemin e-pasuria.</p>
3	<p>Çështja A2 - Pagesa e projekteve në kundërshtim me ligjin e buxhetit.</p>	<p>Në bazë të mostrave të testuar, kemi vërejtur se në tri (3) raste janë kryer pagesat nga fondet e projekteve të aprovuar në ligjin e buxhetit 2024 për projekt tjera.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrata për projektin "Ndërtimi i objekteve për banim social", është nënshkruar në vitin 2022 në vlerën prej 406,747€, bazuar në ndarjet buxhetore të vitit. Megjithatë, projekti nuk ishte realizuar në tërësi gjatë vitit 2022/2023. Si rezultat i kësaj, në vitin 2024, komuna ka kryer pagesë për këtë projekt në vlerën prej 30,000€, duke shpenzuar fondet e projektit "Furnizimi me aparaturo për QKMF-ën".</li> <li>• Po ashtu, Komuna ka kryer pagesë për projektin "Ndërtimi i objekteve për banim</li> </ul>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që të përforcohen kontrollat dhe të rritet përgjegjësia në procesin e ndarjes së fondeve për projektet kapitale, dukë i dhënë prioritet projekteve të papërfunduara nga vitet paraprake.</p>	<p>Janë ndërmarrë veprime për forcimin e kontrolleve në planifikimin, monitorimin dhe ekzekutimin e buxhetit për projektet kapitale, me theks të veçantë në prioritetizimin e projekteve të papërfunduara nga vitet paraprake. Gjithashtu, është rritur kujdesi në ndarjen e mjeteve buxhetore sipas destinimit të aprovuar me Ligjin e Buxhetit, me qëllim që pagesat të realizohen për projektet përkatëse dhe të shmanget përdorimi i fondeve të një projekti për financimin e</p>	<p>Pjesërisht i zbatuar</p>	<p>Një ndër sfidat kryesore në zbatimin e plotë të këtij rekomandimi ka qenë ndikimi financiar i obligimeve që kanë rrjedhur nga Kontrata Kolektive në arsim. Në raste të caktuara, nga Departamenti i Thesarit janë ekzekutuar pagesa për vendime gjyqësore dhe përbarimore, nganjëherë edhe pa paralajmërim paraprak, gjë që</p>

4	<p><b>Çështja A3 - Vonesa në realizimin e projekteve kapitale</b></p>	<p>social", në vlerën prej 30,000€, duke shpenzuar fondet e projektit "Blerja e veturës për kujdesin Pallativ".</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kontrata për projektin "Hartimi i projekteve për Komunën e Kaçanikut" e nënshkruar në vitin 2023 në vlerë prej 120,000€, bazuar në ndarjet buxhetore të vitit. Megjithatë, projekti nuk ishte realizuar në tërësi gjatë vitit 2023. Si rezultat i kësaj, në vitin 2024 komuna ka kryer pagesë për këtë projekt në vlerë 25,106€ duke shpenzuar fondet e projektit "Ndërtimi i rrugës dhe trotuarit Reshat Shehu". Kjo ka ndodhur si rezultat i mos funksionimi të kontrolleve me rastin e përgatitjes, monitorimit dhe ekzekutimit të buxhetit për projekte kapitale. </li></ul>	<p>Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigoroze në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizim eve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen</p>	<p>Janë ndërmarrë veprime për përmirësimin e mbikëqyrjes në menaxhimin e kontratave kapitale, përmes rritjes së monitorimit të zbatimit të punimeve sipas planit dinamik dhe afateve të përcaktuara në kontratë. Po ashtu, gjatë planifikimit dhe realizimit të projekteve është shtuar kujdesi në vlerësimin e kushteve paraprake për zbatim, përfshirë sigurimin e mjeteve buxhetore dhe trajtimin e çështjeve pronësore. Megjithatë, për shkak të</p>	<p>projekte tjera. Po ashtu, është kërkuar përgjegjësi më e madhe nga zyrtarët përgjegjës gjatë përgatitjes dhe zbatimit të projekteve kapitale. Rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar.</p>	<p>Pjesërisht i zbatuar</p>	<p>ka vështirësuar planifikimin dhe menaxhimin e rregullt të mjeteve buxhetore, përfshirë ato të destinuara për investime kapitale. Këto rrethana kanë ndikuar në kufizimin e mundësive për zbatim të plotë dhe në kohë të masave që lidhen me forcimin e kontrolleve dhe menaxhimin më efikas të fondeve për projektet kapitale.</p> <p>Përveç çështjeve të shpronësimit dhe mosrespektimi i afateve nga operatorët ekonomikë, sfida tjetër në realizimin e projekteve kapitale ka qenë vonesa në alokimin e të hyrave vetanake sipas planifikimit, për shkak të vendimeve gjyqësore dhe përbarimore që kanë qenë lëndë prezente në</p>
---	---	---	---	--	---	-----------------------------	--

5	<p>Çështja A4 - Mos përmbushja e kërkesës ligjore për inspektimin e pronave të paluajtshme</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kontrata "Ndërtimi i trotuarit, shtegut për çiklizëm dhe ndriçimit publik në rrugë Murat Lika, Strazhë" në vlerë 122,852€ nuk është kryer sipas planit dinamik 90 ditë. Vonesat për këto kontrata ishin nga 207 deri 524 ditë. Shkak i vonesave ishte mungesa e mjeteve në dispozicion për të përfunduar kontratën si pasojë e planifikimit jo të duhur të projektit dhe të disa problemeve në shpronësimin e pronave, si dhe vendosja e afateve për realizim të projekteve pa një analizë të duhur, si dhe mos përgjegjësia e operatorëve ekonomik në kryerjen e punimeve sipas afatit të paraparë me kontratë.</li> </ul> <p>Ne kemi vërejtur se komuna në vitin 2024 për tatimin në pronë të objekteve nuk kishte bërë asnjë inspektim (verifikimin) të pronave të paluajtshme, siç kërkohet nga ligji në fuqi. Komuna nuk ka ndërmarrë masa ose veprime alternative për verifikimin e 20% të pronave të paluajtshme/objekteve. Sipas komunës shkak i mos kryerjes së inspektimeve të pronave dhe objekteve ishte mungesa e stafit,</p>	<p>masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.</p>	<p>problemeve të evidentuara në disa kontrata, rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar.</p>	<p>I pa zbatuar</p>	<p>Thesarin e Kosovës. Në këto raste, Thesari nuk ka bërë alokimin e mjeteve pa u bërë paraprakisht ekzekutimi i këtyre vendimeve gjyqësore, çka ka ndikuar drejtpërdrejt në mungesën e mjeteve në dispozicion dhe në vonesën e realizimit të kontratave.</p>
		<p>Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.</p>	<p>Për shkak të mungesës së stafit të mjaftueshëm në Zyrën e Tatimit në Pronë, nuk ka qenë e mundur të realizohet inspektimi i nevojshëm i 20% të pronave të paluajtshme gjatë vitit 2024. Megjithatë, komuna ka identifikuar nevojën për forcimin e kapaciteteve në këtë zyrë dhe ka paraparë që, në periudhën në vijim, të shqyrtohet punësimi i një zyrtari shtesë për verifikimin e pronave ose mundësia e kontraktimit të një kompanie private për kryerjen e këtij procesi.</p>		<p>Sfida kryesore në realizimin e këtij rekomandimi kanë qenë numri i limituar i pozitave të punës në Zyrën e Tatimit në Pronë, si dhe buxheti i pamjaftueshëm, të cilat kanë penguar angazhimin e stafit shtesë apo ofrimin e zgjidhjeve alternative për realizimin e inspektimit të kërkuar ligjor të pronave.</p>	

6	<p>Çështja B2 - Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullit Financiare</p>	<p>Nga 26 mostrat e testuara në kategorinë mallra dhe shërbime kemi vërejt se në tri (3) raste në vlerë 34,165.35€, nuk janë respektuar hapat për procedimin e pagesave ku fillimisht është bërë pranimi i mallit dhe shërbimit/furnizimet pastaj është lëshuar zotimi dhe urdhërlerja. Kjo shifër dhe numër është zvogëluar nga viti paraprak, por mbetet prapë për përmirësim.</p> <p>Kjo ishte si pasojë e dështimit të kontrolleve nga zyra e financave dhe prokurimit pasi që zyrtari zotues dhe zyra e prokurimit nuk i kishin respektuar hapat për procedim të pagesave sipas rregullit financiar.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë së ngjarjeve që fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, të nxjerrët urdhërlerja dhe më pas pranimi i mallrave/punëve</p>	<p>Janë ndërmarrë veprime për forcimin e kontrolleve të brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave, me qëllim që procedimi të bëhet sipas rregullave financiare. Po ashtu, përmes SIMFK-së është realizuar ndërlidhja e sistemeve Free Balance dhe e-Prokurimi, gjë që në masë të madhe e detyron respektimin e hapave proceduralë, përkatësisht zotimin e mjeteve, lëshimin e urdhërlerjes dhe më pas pranimin e mallrave, punëve apo shërbimeve, në përputhje me Rregullin Financiare 01/2013 të MF-së.</p>	<p>I zbatuar</p>	<p>Sfida kryesore ka qenë mosrespektimi i plotë i kontrolleve nga zyrtarët përgjegjës gjatë periudhës raportuese, ndonëse me ndërlidhjen e sistemeve është përmirësuar dukshëm kontrolli procedural.</p>
7	<p>Çështja A5 - Hyrja ne obligime kontraktuale pa buxhet dhe fonde të mjaftueshëm</p>	<p>Në bazë të mostrave të testuara kemi identifikuar mangësitë si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Rregullimi i rrugës "Bob-Kulla e Hasanit" në vlerë 327,127€ kurse me Ligjin e buxhetit për këtë projekt, për tri vite ishin ndarë fonde në vlerë 150,000€. Komuna ka hyre në obligime kontraktuale për 171,172€ pa pasur buxhet të aprovuar.</li> <li>Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHFMU "Idriz Seferi" në vlerë 366,700€ kurse me Ligjin e buxhetit për këtë projekt ishin ndarë fonde në vlerë 300,000€. Komuna ka hyre në obligime kontraktuale</li> </ul>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha kontrollet e nevojshme funksionojnë gjatë tërë kohës, në mënyrë që para inicimit të procedurave të prokurimit të sigurohet se projektet kapitale janë të përfshira në ligjin e ndarjeve buxhetore ka fonde të mjaftueshme buxhetore të ndara për të</p>	<p>Komuna ka ndërmarrë hapa për përmirësimin e planifikimit buxhetor për projektet kapitale, përfshirë koordinim më të hershëm ndërmjet drejtorive kërkuese, prokurimit dhe financave, si dhe verifikim më të shtuar të përfshirjes së projekteve në ndarjet buxhetore dhe në planifikimin shumëvjeçar para inicimit të procedurave të prokurimit.</p>	<p>Pjesërisht i zbatuar</p>	<p>Sfida ka qenë se një pjesë e buxhetit të komunës për financimin e kontratave kapitale mbështetet edhe në të hyrat vetanake të bartura, të cilat nuk reflektohen në tabelat fillestare të Ligjit për ndarjet buxhetore. Për këtë arsye, krahasimi vetëm me shumat e paraqitura në</p>

8	<p>Çështja B3 - Vonesa në pagesën e faturave</p>	<p>për 66,000€ pa pasur buxhet të aprovuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërtimi i "objektit të zjarfikësive Kaçanik Faza II-të" në vlerë 143,516 kurse me Ligjin e buxhetit për këtë projekt ishin ndarë fonde në vlerë 50,000.00 €. Komuna ka hyre në obligime kontraktuale për 93,516€ pa pasur buxhet të aprovuar.</li> </ul> <p>Kjo dukuri ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit pa pasur buxhet të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës dhe pa fonde të mjaftueshme.</p>	<p>gjitha kontrata e lidhura.</p>	<p>Kryetari duhet të forcojë kontrollin e në menaxhimin e faturave, duke siguruar se pagesat bëhen brenda afatit të përcaktuar ligjor.</p>	<p>Komuna ka ndërmarrë masa për përmirësimin e menaxhimit të faturave dhe obligimeve, duke rritur koordinimin ndërmjet drejtorive kërkuese, zyrës së prokurimit, zyrës së pranimit dhe zyrës së financave me qëllim që faturat të procedohen më shpejt për pagesë.</p> <p>Këto veprime janë në përputhje me Rregullën Financiare Nr. 01/2013/MF, e cila kërkon që çdo faturë e vlefshme për mallra dhe shërbime të pranuar të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e pranimit të faturës, si dhe me detyrimet e ZKF-së dhe Zyrtarit Certifikues për të siguruar ligjshmërinë</p>	<p>Pjesërisht i zbatuar</p>	<p>ligjin vjetor nuk e pasqyron gjithmonë gjendjen e plotë të mjeteve të disponueshme</p>
				<p>Në pesë (5) raste, faturat në vlerë totale prej 4,451€, për ndërtimi i fushës sportive në vlerë 1.555€, rregullimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit vertikal dhe horizontal në Komunën e Kaçanikut në vlerë 1.695€, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike në vlerë në vlerë 516€, mirëmbajtje e objekteve dhe pajisjeve mjekësore në vlerë 500€ dhe paga për shërbime këshilluese në vlerë 185€ të paraqitura në RVF, përfaqësojnë fatura të papaguara për më shumë se 30 ditë, me vonesë nga 30 ditë deri në 81 ditë.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve jo adekuata në ekzekutimin e pagesave dhe menaxhim të kontratave publike, mungesës së fondeve financiare për realizimin e pagesave brenda afatit ligjor.</p>	<p>Pavarësisht masave të ndërmarra, sfida kryesore ka qenë planifikimi i rrjedhës së parasë, si dhe ekzekutimet nga Thesari pa paralajmërim të mëparshëm, të cilat kanë ndikuar në disponueshmëri në e mjeteve për pagesën me kohë të faturave.</p>		

9	Çështja B4 - Mungesa e projektit ekzekutues	<p>Nga testimi jonë ka rezultuar se për dy (2) projekte kapitale nuk ishin përgatitur projektet ekzekutive, rastet kanë të bëjë me projektet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve urbane - Kaçanik (Ritender) në vlerë 147,667€.</li> <li>Ndërtimi i depos dhe garazhës në QKMF në vlerë 214,465€.</li> </ul> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së njërive kërkuese pa bërë paraprakisht hartimin e projekteve ekzekutive zbatuese dhe mos funksionimit efikas të kontrolleve tek zyra e prokurimit duke zhvilluar procedurat pa u përmbyshur kërkesat ligjore.</p>	Kryetari duhet të sigurohet se funksionon kontrolli i duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuese bëjnë hartimin e projektit ekzekutiv sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.	dhe rregullsinë e pagesave. Komuna ka ndërmarrë masa konkrete për adresimin e kësaj çështjeje, duke kontraktuar kompani profesionale për hartimin e projekteve dhe dokumentacionit teknik për investimet kapitale. Si rezultat, për projektet që planifikohen për inicim në procedurat e prokurimit tashmë përgatitet paraprakisht projektet ekzekutiv në detaje, në përputhje me nevojat e komunës dhe kërkesat teknike për realizimin e punimeve. Gjithashtu, është rritur kontrolli nga njësitë kërkuese dhe zyra e prokurimit, me qëllim që procedurat të mos iniciohen pa dokumentacionin e nevojshëm teknik.	Pjesërisht i zbatuar	Sfidat janë paraqitur kryesisht te disa ndërhyrje të vogla infrastrukture, ku për shkak të natyrës së kufizuar të punimeve ka pasur vështirësi praktike në përgatitjen e dokumentacionit teknik në të njëjtin nivel detajimi si për projektet më të mëdha.
10	Çështja B5 - Dobësi në menaxhimin e kontratave përmes platformës elektronike të e-prokurimit	<p>Në bazë të mostrave të testuara, në katër (4) raste, menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve nuk është mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik (e-prokurimi), si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale - Kaçanik në vlerë 276.480€.</li> <li>Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHFMU "Idriz Seferi" në vlerë 367,000€.</li> </ul>	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.	Komuna ka ndërmarrë hapa për përmirësimin e menaxhimit të kontratave përmes platformës elektronike të e-prokurimit. Menaxherët e kontratave kanë ndjekur trajnimet për përdorimin e sistemit dhe tashmë posedojnë njohuritë e nevojshme për menaxhimin dhe arkivimin e kontratave përmes platformës.	I pa zbatuar	Sfida kryesore në zbatimin e këtij rekomandimi ka qenë kallimi nga praktikantët e mëparshme manuale dhe arkivimi fizik i dokumentacionit në përdorimin e plotë të platformës elektronike të e-prokurimit. Edhe pse menaxherët

11	Çështja B6 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme	<p>Edhe përkundër faktit se gjatë vitit 2024, komuna ndërmoi veprime për të mbledhur borxhet duke dërguar faturat/obligimet e paguara në përbarim. Llogaritë e arkëtueshme në total, krahasuar me vitin e kaluar, janë rritur nga 1,973,138€, në 2,315,991€, duke shënuar një diferencë prej 342,853€, ose</p>	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e të arkëtueshmeve, si dhe rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre. Po ashtu të analizohen shkaktarët e	Komuna ka ndërmarrë veprime për përmirësimin e menaxhimit dhe arkëtimin të llogarive të dërgimin e obligimeve të paguara në procedurë përbarimore, monitorimin më të rregullt të debitorëve	I pa zbatuar	<p>e kontratave kanë ndjekur trajnimet dhe posedojnë njohuritë e nevojshme për përdorimin e sistemit, një pjesë e tyre kanë qenë të mësuar me metodat klasike të menaxhimit të kontratave, gjë që ka ndikuar që zbatimi në praktikë të mos jetë ende i plotë në të gjitha rastet. Për këtë arsye, nevojitet monitorim dhe mbikëqyrje më e vazhdueshme për të siguruar që të gjitha veprimet dhe vlerësimet të evidentohen dhe arkivohen përmes platformës elektronike.</p> <p>Sfidat në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme lidhen kryesisht me rritjen e obligimeve nga tatimi në pronë, paqartësitë e krijuara nga diskutimet në nivel qendror për</p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërtimi i objektit për Zjarrfiksit- Kaçanik, Faza e dytë në vlerë 143.516€.</li> <li>Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin "Begracë" në vlerë 295.121€.</li> </ul> <p>Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin e menaxhimit të kontratave përmes platformës elektronike të e-prokurimit.</p>						

		<p>rreth 14.8%. Rritja ka të bëjë me tatimi mbi pronën. Dobësitë e identifikuara lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efikase në menaxhimin përkatësisht arkëtimit të tyre.</p>	<p>rritjes së të arkëtueshmeve si dhe të krijorë strategji të mbledhjes së tyre, përfshirë dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme ligjore për inkasim.</p>	<p>dhe trajtimin më të kujdesshëm të borxheve të mbledhura kryesisht nga tatimi në pronë. Po ashtu, është rritur vëmendja në analizimin e strukturës së të arkëtueshmeve dhe në evidentimin e kategorive që paraqesin vështirësi më të mëdha në inkasim.</p>		<p>trajtimin e këtyre obligimeve, si dhe me ekzistimin e një totali të konsiderueshëm të borxheve të vjetra nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë, tash joaktive, që padyshim vështirësojnë inkasimin.</p>
<p>12</p>	<p>Çështja A6 - Mos funksionalizimi i NJAB-së</p>	<p>Udhëheqësja e NJAB-se me datën 21.03.2025 kishte dalë në pension dhe komuna nuk kishte ndërmarr masa në funksionalizimin e NJAB-së. Shkak i është se pensionimi i udhëheqësit të NJAB-se dhe menaxhmenti nuk ka treguar përgjegjësi të duhur për angazhimin e auditorit të brendshëm / udhëheqësit të NJAB të rëndësishme në monitorimin e funksionimit të kontrolleve të brendshme.</p>	<p>Komuna duhet të sigurojë që NJAB te mos mbetet pa udhëheqës se NJAB- se dhe të ndërmarr masa në angazhimin e një udhëheqës se NJAB-se.</p>	<p>Kjo çështje është adresuar nga Komuna, pasi janë përfunduar me sukses procedurat e rekrutimit për pozitën brenda Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB). Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ka qenë aktiv edhe Komiteti i Auditimit, i cili ka kontribuar në ruajtjen e një niveli të mbikëqyrjes në fushën e kontrollit të brendshëm.</p>	<p>I zbatuar</p>	<p>Sfida ka qenë pamundësia e inicimit të procedurës së rekrutimit përderisa pozita ka qenë formalisht e plotësuar nga zyrtarja në detyrë, deri në momentin e pensionimit të saj. Vetëm pas lirimit të pozitës ka qenë e mundur hapja e konkursit dhe zhvillimi i procedurës së rekrutimit.</p>

Gjetje: 12, Rekomandime: 12

Statusi i rekomandimeve: I zbatuar (2), Pjesërisht i zbatuar (7), I pa zbatuar (3)